



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:004854

Datë: 29.06.2020

Numri i dokumentit: 00994708

C.nr.98/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses RR.R nga Ferizaj Rr..., të cilën e përfaqëson me autorizim M.A, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, me objekt të shqyrtimit gjyqësor pagesën e pagave jubilarë, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 26.06.2020, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës mori, kurse me datën 29.06.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses RR.R nga Ferizaj Rr..., si e bazuar.
- II. DETYROHET** e paditura Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, që paditëses tia paguaj shumën prej 2,142.36€ (dy mijë e njëqind e katër dhjetë e dy euro e tridhjetë e gjashtë cent) në emër të tri pagave jubilarë, me kamatë ligjore prej 8% prej datës 26.06.2020 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30€, të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja me anë të padisë ka theksuar se tek e paditura ka qenë në marrëdhënie të punës me rastin e daljes në pension me datën 11.09.2019, ku ka pasur përvojë të punës mbi 30 vite, ku me rastin e daljes në pension edhe përkundër kërkesës me shkrim e paditura ia ka paguar vetëm tri paga përcjellëse në pension, por jo dhe tri paga jubilarë në shumë prej 2,142.36€, duke marr parasysh se paditësja tri pagat e fundit mujore i ka pasur nga 714.12€, të cilin detyrim e ka pasur sipas nenit 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë si të bazuar me kamat ligjore prej 8% si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurës në seancën e datës 26.06.2020, ka munguar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flet kthesa e Gjykatës ku ftesën s'bashku me procesverbalin e seancës të datës 16.06.2020, e ka pranuar me datë 16.06.2020, shtyrjen nuk e ka kërkuar dhe mungesën nuk e ka arsytuar, andaj Gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditurës konform nenit 423 par. 4 të LPK-së.

E paditura me anë të përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar për faktin se ka theksuar se paditëses me vendimin e datës 10.09.2019, i janë kompenzuar tri paga përcjellëse në pension, por ka theksuar se sa i përket tri pagave jubilarë e paditura nuk ka mjete buxhetore, si rezultat i të cilës nuk ka obligim që t'ia paguaj tri paga jubilarë edhe përkundër asaj që është paraparë me Kontratën Kolektive Sektoriale.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzon në tërësi si të pa bazuar

Gjykata me qëllim të vërtetimit në mënyrë të drejtë gjendjen faktike ka bërë administrimin e provave Lexohet autorizimi i paditëses dhe përfaqësuesit M.A i datës 03.12.2019, lexohet vërtetimi leshur nga e paditura ne emër të paditëses nume protokolli 903 datës 01.12.2019, vendimi i lëshuar nga e paditura ne emër të paditëses me numër 690/19 datës 10.09.2019, vendimi i te paditurës P.877 datës 19.11.2019, qarkullimi bankar lëshuar nga NLB Banka datës 02.12.2019, lista e pagës për muajin shtator 2019 ne emër te paditëses, kërkesa e paditëses drejtuar te paditurës ne procedure administrative nume protokolli 289 datës 01.04.2019, përgjigja e dhënë nga Ministria e shëndetësisë numër protokolli 366 datës 23.04.2019, përgjigja e datës 10.04.2019, vendimi i të paditurës numër 691/19 datës 10.09.2019, me te cilën paditësja duhet të kompensohet për tri pagat përcjellëse, lista e pagës për muajin dhjetor 2019.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të tjera të lëndës, përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës në kuptim të nenit 8 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mes palëve se paditësja për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, si dhe përvoja e punës me rastin e daljes në pension ka qenë mbi 30 vite, por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë të tri pagave jubilarë, në shumën prej 2,142.36€, ka marr për bazë listën për muajin shtator si dhe qarkullimin bankar lëshuar nga TEB Bank e datës 02.12.2019, ku shihet se paditësja ka realizuar pagën neto prej 714.12€ në tre muajt e fundit.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesë padisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, për punëmarrësin dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës siç parashihet me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në nenin 17 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se të punsuarit me rastin e pensionimit gëzojnë të drejtën e kompensimit të tri pagave jubilarë dhe tri pagave për përcillje në pension sipas kushteve që janë të përcaktuara për secilin rast veç e veç.

Në nenin 17 par.3 pika 3.1. 3.2 dhe 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale është paraparë që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një pagë mujore, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy paga mujore, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave mujore, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilarë, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditëses brenda një muaji nga dita e daljes në pension sipas nenit 17 par.4 t'ia paguaj tri paga jubilarë pasi që e ka plotësuar këtë kusht, meqenëse e njëjta ka përvojë pune mbi 30 vite, e cila vërtetohet me anë listës së pagave të që paditëses ka përvojë pune 35 vite dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Sa i përket kundërshtimit të paditurës në lidhje me lartësinë e pagës gjykata konsideron se duke u bazuar në listën e pagës, transaksionin bankar rezulton se paga neto e paditëses ka qenë 714.12 euro dhe kjo duke u bazuar edhe në kontratën kolektive në nenin 17 të Kontratës Kolektive Sektoriale lidhur me 44 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e parasheh paga e të punësuarit përbëhet nga paga bazë, shtesat.

Sa i pretendimit të paditurës se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditëses, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara pasi që deri sa e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë

kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditëses.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të kompensimit të tri pagave jubilarë në pension, paditëses i ka njohur të drejtën e kamatës nga dita 26.06.2020 deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, ku obligohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 30€, në emër të taksës gjyqësore për padi.

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.98/20, me datën 29.06.2020**

**Gjyqtari,
Alban Beqiri**

KESHILLA JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.